



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 331/6 Prot.

Tiranë, më 5/5/2016

V E N D I M

Nr. 16, datë 5/5/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "**Kalemi Travel & Tours**" Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 84, datë 31/03/2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "**Kalemi Travel & Tours**" (Nipt L52101158S), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ana e personit me iniciale në kuadër të përpunimit të të dhënave personale gjatë fushatave promovionale dhe marketingut dhe verifikimi i ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Kontrolluesi "**Kalemi Travel & Tours**" është agjensi udhëtimesh (operator turistik) dhe gjatë ofrimit të shërbimeve përpunon të dhëna personale kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klientë". Kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbledh dhe përpunon të dhëna personale të klientëve (emri, mbiemri, numër telefoni, adresa e-maili), nëpërmjet "mandat arkëtimit" i cili firmoset nga klienti dhe agjenti i kompanisë. Është për tu vlerësuar fakti që kontrolluesi e informon klientin mbi përpunimin e të dhënave për qëllim marketingu (nëpërmjet kushteve të kontratës) dhe mundësia që i jep klientëve për tu regjistruar nga marrja e e-maileve të marketingut.

1. Në kuadër të trajtimit të ankesës (objekti i parë i Urdhrit), është konstatuar se adresa e e-mailit të ankuesit ishte e regjistruar në bazën e të dhënave të klientëve të kontrolluesit. Përfaqësuesi i kontrolluesit pohoi se e-maili i marketingut ishte dërguar nga kompania "**Kalemi Travel & Tours**" nëpërmjet adresës turizem@kalemitravel.com.

Kontrolluesi, në mbështetje të pretendimeve të paraqitura në formë shkresore, paraqiti (gjatë seancës dëgjimore të mbajtur në datën 25/04/2016) në cilësinë e provës mandatin e arkëtimit

të firmosur nga ankuesi, print-screen nga sistemi për një udhëtim që është kryer prej tij me këtë agjensi dhe e-mailin që kontrolluesi u ka drejtuar disa personave që kanë bërë prenotim (ndër të cilët edhe ankuesi).

Në përmbajtje të "mandat arkëtimit" parashikohet: *"Me firmosjen e këtij mandati pranoj kushtet e kontratës, e cila gjendet online në website www.kalemitravel.com dhe jam dakort që pagesa e bërë është e pakthyeshme në rast anullimi nga ana ime"*.

Referuar "kontratës së paketave të udhëtimit" të publikuar në faqen e internetit rezulton se në pikën 18 të saj parashikohet dispozita mbi "Të dhënat personale". Nëpërmjet kësaj dispozite kontrolluesi garanton se përpunimi i të dhënave do të bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar, të dhënat do të përpunohen në përputhje me qëllimin, nuk do t'u përhapen palëve të treta. Gjithashtu parashikon se dhënia e numrit të telefonit dhe adresës së e-mailit është në vullnetin e lirë të klientit. Sa i përket qëllimit të marketingut, në kontratë specifikohet: *"Për t'ju mundësuar shërbime sa më të mira, Kalemi Travel, vetëm me pëlqimin tuaj, do të përdorë të dhënat personale për qëllime të marketingut direkt. Ju mund të zgjidhni që të mos kontaktoheni për të gjithë fushën e marketingut direkt ose edhe për kategori të veçanta të tij. Kështu, ju mund të bëni ankesë të veçantë rreth: direct mail; facebook; e-mail; outbound telemarketing; dhe pjesëmarrjes në kërkim tregu"*. Në kontratë parashikohet edhe e drejta e klientëve për të aksesuar dhe korrigjuar të dhënat personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se provat e administruara vërtetojnë që ankuesi i ka dhënë të dhënat e tij personale me pëlqim të plotë duke nënshkruar mandatin e arkëtimit, në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar. Gjithashtu, në e-mailin e marketingut parashikohet mundësia e çregjistrimit (opsioni "unsubscribe") dhe mesazhi promocional jep mundësinë që refuzohet marrja e mëtejshme e mesazheve. Kjo sjell si pasojë, rrëzimin e pretendimeve të ankuesit për paligjshmëri të përpunimit të të dhënave gjatë marketingut.

2. Në lidhje me objektin e dytë të Urdhrit, nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se nuk ishte përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: *"...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji"*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

3. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "Kalemi Travel & Tours" nuk kishte hartuar një "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj. në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datë 25/04/2016 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Kontrolluesi ka depozituar pretendime nëpërmjet shkresës nr. 331/5 prot, datë 18.04.2016, administruar në dosjen hetimore në cilësinë e provës dhe gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit ka dorëzuar disa prova të reja lidhur me ankesën.

Në tërësi kontrolluesi nuk i ka kundërshtuar konstatimet e Komisionerit por ka deklaruar që mangësitë kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes së ligjit. Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk përbën shkak për mospërbushja e detyrimeve ligjore dhe përjashtimin nga përgjegjësia.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat "d" dhe "dh" të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë;
- Kontrolluesit ose përpunuesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar mbi përpunimin e të dhënave dhe masat e sigurisë në zbatim të ligjit. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si dhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 29, 30, 31, 39/1/d dhe 39/1/dh, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenit 72/3 të Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":

VENDOSA:

1. Dënimin e kontrolluesit **"Kalemi Travel & Tours"** me gjobë, në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit **"Kalemi Travel & Tours"** me gjobë, në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 5.5 2016.

